



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:176166

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05936409

P.nr.210/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit B. F., për shkak të veprës penale: “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2960/24, të datës 28.06.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë me datë 10.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Vjosa Bytyçi, të pandehurit dhe avokates mbrojtëses së tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. A. E., me datë 11.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. F., nga i ati M. dhe nëna R. e vajzërisë R., i lindur më ... në fshatin K. Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i pesë (5) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 22.06.2024, deri me datë 10.07.2024.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me datë 22.06.2024, rreth orës 11:30 minuta, në fshatin Ll., Komuna P., saktësisht në parkingun e “V. F. S.”, me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, fillimisht përdor forcën ku me një guri thyen xhamin e veturës “G. ...” ngjyrë e k., me targa ..., dhe nga aty merr trotinetin elektrik, me ç ‘rast të dëmtuarit B. A. i shkakton dëm material në vlerë prej dyqind e gjashtëdhjetë (260) Euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe të neneve 242, 364, 367, 452 par. 4 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me Dënim me Burgim dhe Dënim me Gjobë

I. Ashtu që i cakton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) vjet, i cili dënim do të filloj së ekzekutuari në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë, në kuadër të cilit i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, nga data 22.06.2024, deri me datë 10.07.2024 dhe

II. DËNIM ME GJOBË në shumën prej dyqind (200) Euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë dhe në rast të pamundësisë apo refuzimit për ta paguar gjobën, atëherë dënimi me gjobë do t' i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do t' i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. I pandehuri lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale nga neni 449, paragrafit 2, nën-paragrafët 2.1 deri në 2.6, dhe nën-paragrafit 2.9 të KPP-së, ngase pagesa e tyre do ta rëndonte gjendjen materiale të pandehurit apo të personave që detyrohet t' i mbështes materialisht.

III. I dëmtuari B. A., me vendbanim në fshatin H., Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2960/24, të datës 28.06.2024, kundër të pandehurit B. F., për shkak të veprës penale: “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.07.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të njëjtit në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke i pohuar në tërësi faktet e përshkruara si në aktakuzë, veprime për të cilat ka shprehur keqardhje dhe është penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo kryej vepra tjera penale, përveç kësaj i njëjti ka shprehur gatishmëri për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale, ndërsa sa i përket vendimit mbi dënimin, nga gjykata ka kërkuar të merr në konsideratë gjendjen e rënduar shëndetësore të prindit (babait) të tij dhe t' i shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Gjykata konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pranimi i

fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i njëjti, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që ky pranim është bërë me vullnetin e tij dhe në përputhje të plotë me shkresat e lëndës dhe me atë se për çfarë akuzohet i njëjti, me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nga gjykata ka kërkuar që rrethana rënduese të merr për bazë shkallën e lartë të dashjes, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar me aktgjykime të formës së prerë për vepra tjera penale të natyrës së njëjtë, andaj ka propozuar që ndaj të njëjtit t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv pasi që vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr për bazë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësja e të pandehurit avokat A. E., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga gjykata ka kërkuar që me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë qysh në fillim të kësaj procedurë penale, pendimin për veprën penale të kryer nga ana e tij, është mbajtës i vetëm i familjes, kujdeset për të dy prindërit e tij të cilët janë në moshë të shtyrë si dhe pesë fëmijët e tij, është rast social, i gjendjes së rënduar ekonomike dhe shqiptimi i dënimit me burgim do të paraqiste vështirësi në jetesën e familjarëve të tij, andaj nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion penal tjetër nga ai me burgim efektiv.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 315 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, gjendjen e dobët ekonomike të tij, rast social, sipas kartelës së ndihmës sociale me nr. regjistrin ... , i datës 03.08.2023, lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në P., është mbajtës i vetëm i familjes, prind i pesë (5) fëmijëve, nën përkujdesjen e të cilit janë edhe të dy prindërit e tij të moshuar, vullnetin e shprehur për të kompensuar palën e dëmtuar për dëmin e shkaktuar, rrethanë tjetër lehtësuese dhe me rëndësi të cilën gjykata e mori në konsideratë me rastin e caktimit të dënimit është gjendja e rënduar shëndetësore e babait të pandehurit, rrethanë kjo për të cilën si dëshmi ka ofruar dokumentacionin mjekësor si: Kopja e Raportit Eko-Kardio Grafik lëshuar nga QKUK në P., i datës 20.06.2024, , Tomografia e kompjuterizuar – 64, lëshuar nga Klinika e Radiologjisë – P., i datës 20.06.2024, Raporti Specialistik lëshuar nga QKUK P., Klinika e Radiologjisë, i datës 13.06.2024, Fletë lëshimi me nr. të amzës ..., lëshuar nga SHSKUK, i datës 25.06.2024, Raporti mbi ekzaminimin dhe përcaktimin e diagnozës nga Poliklinika “V. L.” në P., i datës 10.06.2024, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh dashjen e lartë të kryesit për të kryer veprën penale, e

manifestuar përmes veprimeve proaktive të tij të cilat i pandehuri i ka ndërmarrë ditën kritike, bazuar në të dhënat e siguruar nga evidenca penale rezulton se i njëjti edhe më parë ka qenë i gjykuar për vepra tjera penale dhe atë sipas 1) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 16.06.2011, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK), i dënuar me dënim me kusht, 2) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 26.01.2011, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me kusht, 3) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 25.01.2011, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 155 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, 4) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 15.06.2011, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me kusht, 5) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 18.04.2013, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, 6) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 27.07.2012, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, 7) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 07.07.2017, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me kusht, 8) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 10.09.2015, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, 9) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 23.05.2017, për veprën penale Kanosja nga neni 185 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro, 10) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.618/2008, data e plotfuqishmërisë 06.01.2010, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) Euro, 11) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr., data e plotfuqishmërisë 24.10.2013, për veprën penale Grabitja nga neni 255 par. 3 të KPK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj, 12) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prizren P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 28.05.2015, për veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me kusht, 13) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 09.11.2006, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 1 dhe par. 5 të KPK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, 14) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 07.02.2007, për veprën penale Kanosja nga neni 161 par. 2 të KPK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) Euro, 15) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 25.07.2019, për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzet (20) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) Euro, 16) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 29.08.2019, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 të KPK-së, i dënuar me dënim me kusht, 17) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 22.11.2023, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro dhe 18) aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. ..., data e plotfuqishmërisë 27.05.2024, për veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) muaj, andaj duke i vlerësuar këto rrethana gjykata ka ardhur në

përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim në dënimin e shqiptuar është marrë në bazë të nenit 79 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 452 par. 4 KPRK-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr. 444/2023, datë 29.04.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.